

## **Lulëzim ETEMAJ**

### **ROLI I ADEM DEMAÇIT NË LËVIZJEN E PAJTIMIT TË GJAQEVE 1990-1991 NË KOSOVË**

#### **Abstrakt:**

*Më 29 janar 1990 ish të burgosurit politikë, studentë të Universitetit të Prishtinës, Have Shala, Myrvete Dreshaj, Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj morën vendimin për të filluar aksionin për Pajtimin e Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave në Kosovë. Pas pajtimit të parë, të arritur më 10 shkurt 1990 ndërmjet Fazli dhe Idriz Buçollit të fshatit Raushiq të Pejës, atyre iu bashkëngjitën edhe Zogë Shala, së bashku me Akile Dedincën nga fshati Vragoli i Fushë-Kosovës, që të dyja ish të burgosura politikisht. Kështu, numri i vajzave, ish të burgosura politike, në raport me numrin e djemve, në këtë grup tani ishte katër me tre, në favor të vajzave. Kuptohet, bëhet fjalë për një periudhë të caktuar, ngaqë Akile Dedinca kthehet pas një kohe për ta përhapur Pajtimin e Gjaqeve edhe në vendbanimin e saj, ndërsa në grup kyçet Ethem Çeku, po ashtu ish i burgosur politik. Që nga kjo kohë grupi i të rinjve të Pejës do të ketë raport konstant, tri ish të burgosura politike: Have Shala, Myrvete Dreshaj dhe Zogë Shala, si dhe katër ish të burgosur politikë: Adem Grabovci, Brahim Dreshaj, Ethem Çeku dhe Lulëzim Etemaj. Ndërkaq barazimin në numër të të rejave e arrin Luljeta Grabovci, studente, e cila i bashkëngjitet atij grupi që nga dita e parë, për të mos u ndalur deri në përfundimin e veprimtarisë së Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë.*

**Fjalët kyçe:** *Kosovë, Adem Demaçi, pajtim, burgim, ish të burgosur politikë, liri, çlirim.*

Pas ftesës së bërë nga nismëtarët në takimin e realizuar me ta në Prishtinë, aksionit iu bashkëngjitën edhe profesorët e Universitetit të Prishtinës, Anton Çetta dhe Zekeria Cana. Më pastaj u bashkëngjitën me mijëra, pa dallim moshe, gjinie, arsimimi dhe rajoni. Ata treguan përkushtim dhe vendosmëri shembullore. Kështu brenda dy-tre muajsh e shndërruan aksionin në lëvizje gjithëpopullore. Lëvizja e Pajtitimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë është një lëvizje autentike në historinë e popullit shqiptar dhe jo vetëm. Rezultati i lartë i arritur gjatë veprimtarisë së saj njëvjeçare: falja e 1 169 gjaqeve, 477 plagëve dhe 865 ngatërresave<sup>1</sup> në mënyrë vullnetare, pa kompensim apo çfarëdo kushti të shtruar, si dhe shtrirja që kishte ajo, janë disa prej karakteristikave të saj më të veçanta. Adem Demaçi, heroi i Kosovës dhe i të gjithë kombit shqiptar, me 28 vjet burgim politik mbi supe, për shqiptarët e Kosovës personifikon kryeideologun, institucionin kombëtar, me emrin e të cilit është e lidhur fuqishëm çdo përpjekje për liri, të drejta njerëzore dhe kombëtare, përfshirë edhe luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Çlirimi, liria dhe pavarësia e Kosovës janë pjesë të pashkëputura edhe të Lëvizjes së Pajtitimit të Gjaqeve në vitin 1990-1991 në Kosovë, si simbol dhe si filozofi me karakter të çlirimit social dhe kombëtar njëkohësisht. Të gjithë periudhën e pajtitimit të gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave e ka shoqëruar motoja e Adem Demaçit nga romani “Gjarpinjtë e gjakut”<sup>2</sup>: *“Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtitimit”!*

<sup>1</sup> Lulëzim Etemaj, *Lëvizja e Pajtitimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë*, Armagedoni, Prishtinë, 2020, 128.

<sup>2</sup> Titulli origjinal i botimit të parë. Botuar nga *Jeta e re*, Prishtinë, 1958. Titulli i këtij libri do të përdoret në origjinal edhe në këtë punim.

Në këtë punim do të trajtohet ndikimi si dhe reflektimi i saj, krahas gjithë filozofisë politike dhe qëndresës së tij, si pjesë pragmatike e fillimit të aksionit, shtrirjes dhe zhvillimit të tij dhe përgjithësisht e Lëvizjes së Pajtit të Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave. I gjithë shtjellimi çon në konkluzionin se reflektimi i filozofisë jetësore, politike, kombëtare të Adem Demaçit kanë qenë me peshë të veçantë në Lëvizjen e Pajtit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë, kanë qenë pika nga është dhënë shembulli më i pastër i angazhimit të nismëtarëve, veprimtarëve të shumtë të pajtit si dhe e flijimit për atdhe, në familjet që kërkohej falja e gjakut, plagës dhe ngatërresës si dhe shtrirja e dorës së pajtit.

*“Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtit!”* Kjo është motoja e romanit të Adem Demaçit “Gjarpinjtë e gjakut”, të botuar në vitin e largët 1958, kur Adem Demaçi ishte në moshën 22-vjeçare. Paraprakisht ai ishte botuar në numrin 1 dhe 2 të revistës prestigjioze letrare “Jeta e re”, të cilën e udhëhoqi për dekada me radhë nxitësi dhe mbështetësi i guximshëm i penave të reja dhe i letërsisë shqiptare jashtë Shqipërisë së cunuar, Esad Mekuli. Përkundër faktit që kjo moto e ka shoqëruar që nga nisma për pajtimin e gjaqeve, të plagëve dhe të ngatërresave në Kosovë, deri më tani ka mbetur i patrajtuar reflektimi i saj, përkatësisht ndikimi i veprimtarisë së Adem Demaçit në Lëvizjen e Pajtit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë.

Sikurse më 29 janar 1990, kur nismëtarët e Pajtit të Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave, vendosën për të filluar pajtimin e gjaqeve, Adem Demaçi gjendej në burg edhe më 2 shkurt të vitit 1990, kur ndërmerret ndërhyrja e parë në fshatin Lumbardh të Deçanit, me qëllim përmbushjen e zotimit dhe të misionit të marrë përsipër vullnetarisht prej tyre. “Gjarpinjtë e gjakut” është romani i parë shqiptar në Kosovë. Pararendës i ka vitet e egra të dhunës dhe të represionit të pushtuesit mbi shqiptarët, posaçërisht të dhunës së ushtruar gjatë viteve 1956 dhe 1957, kur policia e udhëhequr nga Aleksandar Rankoviq, nën arsyetimin e “grumbullimit të armëve pa leje” aplikoi terrorin në funksion të krijimit të një atmosfere frike, që do të favorizonte

përshejtimin e dëbimit të shqiptarëve në Turqi, dëbim i kamufluar me të ashtuquajturën “shpërngulje vullnetare”. Si pasojë e torturave barbare gjatë “aksionit të armëve” në Kosovë humbën jetën 100 persona, ndërsa me pasoja fizike dhe psikike të përjetshme mbetën 30 000 shqiptarë të tjerë.<sup>3</sup>

Aleksandar Ranković ishte themelues dhe që nga vitit 1944, edhe drejtues i Shërbimit Sekret Policor, Civil dhe Ushtarak, jugosllav “Odseka za Zaštitu Naroda” (OZN), në gjuhën shqipe: “Sektori për Mbrojtjen e Popullit”, gjegjësisht pasuesve të këtij shërbimi nga vitit 1946, “Uprava državne bezbednosti” (UDB) dhe “Kontraobaveštajna služba” (KOS), “Drejtoria e Sigurimit Shtetëror” dhe “Shërbimi i Kundërzbulimit”.<sup>4</sup>

Ranković shkarkohet me motivin për keqpërdorimin e detyrës nga të gjitha funksionet në Plenumin IV të Komitetit Qendror (KQ) të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë (LKJ), i cili njihet si Plenumi i Brionëve<sup>5</sup>, i mbajtur më 1 korrik të vitit 1966. Ndër akuzat tjera që i vihen mbi supë Aleksandar Rankovićit janë edhe burgosja, torturimi si dhe vrasja e mijëra të burgosurve politikë.<sup>6</sup> Ndërkaq, me numrin prej 41 800 shqiptarëve të shpërngulur vetëm në vitin 1958, 54 000 në vitin 1956 dhe 57 710 në vitin 1957, ku numri i përgjithshëm i shqiptarëve të shpërngulur dhunshëm vetëm gjatë këtyre tri vjetëve arrin shifrën prej 153 510 vetash.<sup>7</sup> Si përfaqësues kryesor i Serbisë, Ranković gjatë kësaj periudhe mbi njëzetvjeçare shquhet gjithashtu për angazhimin në funksion të unitarizmit jugosllav me shenja të qarta të serbomadhezmit.<sup>8</sup>

<sup>3</sup> Kadri Rexha, *Fati i luleve*, “Buzuku”, Prishtinë, 1993, 85.

<sup>4</sup> Srećko M. Džaja: *Die politische Realität des Jugoslawismus (1918-1991): Mit besonderer Berücksichtigung Bosnien-Herzegowinas (Untersuchungen zur Gegenwartskunde Südosteuropas. Band 37)*. Oldenbourg, München, 2002, 133.

<sup>5</sup> Ishuj në pjesën kroate të Adriatikut.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Hakif Bajrami, *Shpërngulja e shqiptarëve në Anadoll 1951-1966*, “Epoka e re”, 15 janar 2015, 11.

<sup>8</sup> Ludwig Steindorff: *Zwischen Aufbruch und Repression: Jugoslawien 1945-1966*. In: Dunja Melčić (Hrsg.): *Der Jugoslawien-Krieg: Handbuch zu Vorgeschichte*,

Kjo kohë e rëndë, kohë në të cilën po jetonte populli i shtypur shqiptar, është bërë objekt i trajtimit specifik, krejt origjinal, duke iu nënshtruar pasqyrimin artistik, psikologjik e filozofik, gjë që e bën romanin “Gjarpinjtë e gjakut” të jetë krejt i veçantë: roman metaforë, për nga struktura e tij estetike. Roman që, sado i veshur me shije me petkun letrar, në të vërtetë është një mesazh i fortë njerëzor, politik, kombëtar, drejtuar bashkëkombësve; mesazh që ngërthen thirrjen, klithmën, për të braktisur konfliktet mes tyre, veçanërisht gjakmarrjen dhe bashkuar të gjitha energjitë kundër pushtuesit të vendit.

“*Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit!*”: ky është synimi bosht i romanit, të cilin e bart personazhi i Mustafës, që në të vërtetë është vetë Adem Demaçi. Demaçi, duke parë se si gjarpërinjtë e gjakut tonë së bashku me gjarpërinjtë e sistemit të pushtuesit, duke ia marrë gjakun, po e varfëronin dhe po e rrezikonin jetën e shqiptarëve, substancën dhe mbijetesën tonë kombëtare në trojet tona shekullore, duke qenë i pakompromis, fton fuqishëm popullin, posaçërisht rininë shqiptare, për t’i dhënë fund vëllavrasjes: “*Mshoju edhe pak, mshoju, e naljau turrin ktyne gjarpnojve t’gjakut, qi po munohen hala me ecë e me i përlye me marre kto male tonat, me e flliqë kit dhé tonin!...- Nalni!... Nalni!... Shtypjauni kryet!...*”<sup>9</sup>

Ky synim bosht i romanit, përkatësisht filozofia çlirimtare e tij, i siguroi Adem Demaçit mirëpritje të matur në qarqet letrare të kohës, kurse nga ana e lexuesve të shumtë, veçanërisht te rinia, e cila po e ndiente më shumë se çdokush tjetër përcëllimën e vapën ekzistenciale, që bucinën e kishte bërë tokëllinë, kurse barin e kishte zverdhur dhe njerëzit, shqiptarët, i kishte “teshun në shpirt”<sup>10</sup>, ardhja e tij ishte pritur si ardhja e shiut prej kupës së qiellit, të cilit i ishin lutur në gjuhën shqipe, herë me zë e herë në heshtje, duke drejtuar sytë e lodhur prej

---

*Verlauf und Konsequenzen*. 2. aktualisierte und erweiterte Auflage. VS Verlag für Sozialwissenschaften, 2007, 196.

<sup>9</sup> Adem Demaçi, *Gjarpinjtë e gjakut*, “Jeta e re”, Prishtinë, 1958, 80.

<sup>10</sup> Po aty, 7.

tij. “Nuk asht trimni me vra vllaun e me ia knaqë zemrën dushmanit, trimni asht me falë gjakun e me ndalë vllavrasjen”, këto janë fjalët që dëgjoheshin në biseda nga ata që kishin lexuar romanin e tij si dhe të ata që nuk dinin shkrim-lexim, por të tjerët ua lexonin me zë.<sup>11</sup> Ato njëherit pasqyrojnë ndikimin e madh që kishte filluar të ushtronte Adem Demaçit përmes romanit të porsabotuar. “Gjarpinjtë e gjakut” është romani që i shqiptoi dënimin vendimtar gjakmarrjes dhe njëkohësisht, akuzon shoqërinë, e cila nuk po ndërmerre asgjë për çrrënjosjen e saj.<sup>12</sup> Kështu, ai ishte lexuar dhe vlerësuar edhe prej pushtetit. Prej pushtetit politik dhe prej të gjitha policive të tij. Dhe për pasojë, autorin Adem Demaçi e burgosin po këtë vit, ndërsa vitin tjetër, në muajin shkurt, e nxjerrin para Gjyqit të Qarkut në Prishtinë dhe “në emër të popullit” e dënojnë me 5 vjet burgim të rëndë.<sup>13</sup> Ndërsa romani shpallet i ndaluar. Qarkullimi i tij fillon të bëhej fshehtas, dorë pas dore.

Po ashtu dhe leximi, analizimi dhe komentimi i tij. “Prej këtu ku jam po ju them edhe një herë se, nëse Serbia e Jugosllavia nuk heqin dorë nga okupimi i Kosovës dhe nëse nuk lejojnë që Kosova të shkëputet nga Jugosllavia e t’i bashkohet Shqipërisë, atëherë nuk do të ketë paqe as në Ballkan, as në Jugosllavi, as në Serbi”<sup>14</sup>, - deklaroi Demaçi para këtij gjyqi antishqiptar, në mbrojtje të pikëpamjeve të tij politike dhe të drejtave të ligjshme të shqiptarëve të Kosovës. Katër vjet më vonë, përkatësisht dy vjet pas lirimit nga burgu i parë, në shtator të vitit 1963, Adem Demaçi, së bashku me Fazli Grajçevcin, Zeqir Gërvallën, Azem Beqirin dhe Avdyl Lahun formojnë organizatën politike patriotike Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), me qëllim kryesor, të parë dhe të fundit, sigurimin e së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banuara në

<sup>11</sup> Jusuf Gërvalla, Adem Demaçi - simbol i rezistencës shqiptare, “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1982, 14.

<sup>12</sup> Horward Clark, *Ziviler Widerstand im Kosovo*, "Verlag Weber & Zucht", Kassel, 2003, 75.

<sup>13</sup> Selatin Novosella, *Demaçi, aromë atdheu*, SHBPK, Prishtinë, 2014, 12.

<sup>14</sup> Po aty, 12,13.

shumicë prej shqiptarësh, që gjenden nën administrimin e Jugosllavisë dhe bashkimin e tyre me nënën e vet - Shqipërinë.<sup>15</sup>

Edhe pse që të pesë nismëtarët e pajtimit të gjaqeve në vitin 1990 në Kosovë ishin ish të burgosur politikë, asnjëri nuk kishin pasur rastin të qëndronin me të në të njëjtin burg, dhomë apo qeli. Porse shumica e tyre Adem Demaçin kishin arritur ta njihnin më thellësisht përmes leximit të romanit të tij “Gjarpinjtë e gjakut”. Ai ishte prezent tek ta edhe përmes komentimit dhe analizës që i bënin romanit të tij me ish të burgosur të tjerë politikë gjatë kohës sa ishin në burg, ndërkohë që një pjesë e tyre paraprakisht ishin pyetur edhe për këtë “roman armiqësor” dhe ishin torturuar nga udhëbërës gjatë kohës së hetimeve.

Pavarësisht nga mosnjohja personale, mungesa e takimit fizik mes tyre, është veprimtaria politike në shërbim të çështjes kombëtare; burgimi i vuajtur politik, pra statusi i të burgosurit politik; dalja para gjyqeve antishqiptare dhe dënimi që u shqiptuan ato, ajo që ata i lidhte me Adem Demaçin. Për të pestit, ashtu si për mijëra shqiptarë të tjerë, të të gjitha moshave dhe gjinive, pa dallim arsimimi e profesioni, kishte kaluar shumë kohë, që prej kur Adem Demaçi ishte shndërruar në simbol, prijës shpirtëror i angazhimit dhe i luftës për të drejta të plota njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve të robëruar të Kosovës, i luftës së saj për bashkim me nënën Shqipëri.

Në fundjanarin e vitit 1990, Kosova ishte përfshirë nga një valë e madhe protestash dhe demonstratash paqësore të shqiptarëve, në kërkim të të drejtave dhe lirive njerëzore e kombëtare, të drejta të cilat, sado që në nivel të ulët, ishin rrënuar përtokë një vit më parë me suprimimin e Autonomisë, e cila buronte nga Kushtetuta e vitit 1974. “Kosova - Republikë!”, “Lironi të burgosurit politikë”, “Barazi - Barazi!”, “Rroftë Adem Demaçi”, “Jo, jo, Serbi, nuk do të jesh perandori!” etj.,<sup>16</sup> janë parullat dominuese të brohoritura nga ana e pjesëmarrësve të këtyre demonstratave. Pas refuzimit të kërkesave dhe gjyqimit të demonstratave si “armiqësore” dhe “antijugosllave” nga

<sup>15</sup> Po aty, 14, 15.

<sup>16</sup> Gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 1, janar 1990, 4.

qarqet politike qeveritare, policia speciale jugosllave kishte ushtruar dhunë dhe terror të shfrenuar mbi demonstrues, ku krahas arrestimit të qindra vetave, ishin me qindra të tjerë që kishin marrë plagë trupi nga armët e zjarrit, kurse numri i të vrarëve kishte arritur në 32 veta.<sup>17</sup> Kjo shifër u shndërrua fillimisht edhe në moto të Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve: për 32 të vrarë, 32 fajle gjaqesh.

Situata e re politike në Kosovë kishte krijuar rrethana të reja shtesë, nxitëse të rinisë studentore, për të filluar me pajtimin e gjaqeve. Dhe, sikurse pesë nismëtarët, mund të ketë qenë tejet i madh numri i atyre që, duke qenë jashtë, në shkolla, në fakultete, në vende pune, brenda në burgje apo jashtë atdheut, në mërgim, kanë bluar në kokën e tyre mendimin për domosdoshmërinë e shuarjes së dukurisë së gjakmarrjes, të trashëguar nga Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe të ndihmuar për t'u mbajtur në jetë, përmes veprimeve të drejtpërdrejta, nga ana e pushtuesit. Por nuk ka edhe një njeri të vetëm as para “Gjarpinjve të gjakut” dhe as më pas, që të ketë artikuluar aq haptas dhe po aq drejtpërdrejt thirrjen për pajtimin e gjaqeve, siç ka bërë Adem Demaçi.

Pesha e mendimeve të Adem Demaçit në këtë roman dhe pesha shpirtërore e njeriut (personazhit) që bart barrën e gjakmarrjes “lëviz shpirtërisht lexuesin e tij”, do të shprehej studiuesi Rexhep Qosja, lexuesin deri atëherë të fshehur, lexuesin e ri, siç ishin edhe nismëtarët e pajtimit të gjaqeve. Ata këtij aksioni i falën përkushtimin dhe vendosmërinë, për të jetësuar idetë dhe programin e apostullit të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës.<sup>18</sup> Prandaj romani “Gjarpinjtë e gjakut” dhe Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), e themeluar në shtator të vitit 1963<sup>19</sup>, janë ajo hallka e fortë, shumë e fuqishme, që lidhin pashkëputshëm Adem Demaçin me Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë.

<sup>17</sup> Horward Clark, *Ziviler Widerstand im Kosovo*, “Verlag Weber & Zucht”, Kassel, 2003, 71.

<sup>18</sup> Myrvete Dreshaj, deklaratë dhënë autorit përmes e-mailit, 19 shkurt 2016.

<sup>19</sup> Selatin Novosella, *Metush Krasniqi - personalitet unifikues i Lëvizjes Kombëtare*, “Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës”, Prishtinë, 2011, 88.

Me krijimtarinë e tij letrare dhe me veprimtarinë politike kombëtare, Adem Demaçi kishte kohë që ishte shndërruar në simbol të qëndresës kombëtare. Në të dyja rastet, ai u kishte dhënë nxënësve të tij, rrugëndjekësve politikë të tij, para së gjithash nxënësve të radhëve të para, pjesën dërmuese të të cilëve e përbënin të burgosurit dhe ish të burgosurit politikë të të gjitha kohërave, kodin demaçian; kodin e veprimit, të çlirimit personal dhe kombëtar, i cili shtyllë qendrore kishte vlerat humane, të drejtat dhe liritë njerëzore dhe kombëtare, jo vetëm të bashkëkombësve të tyre, por të të gjithë njerëzve dhe popujve, pa dallim kombi, gjuhe, race, feje e bindjeje politike. Është rrjedhojë logjike, që praktikues konkretë të kodit të Adem Demaçit u bënë ish të burgosurit politikë, të cilët jo vetëm që e filluan, e përhapën dhe e koordinuan pajtimin e gjaqeve, por në bashkëpunim me qindra ish të burgosur të tjerë politikë, brenda dy-tre muajsh e shndërruan atë në Lëvizje Gjithëpopullore.

Për këtë, meritë të jashtëzakonshme, krahas meritoreve kryesorë; familjeve që falën pa asnjë kusht a kompensim gjakun dhe plagët e më të çmuarve të tyre për të shtrirë dorën e pajtimit, kanë edhe intelektualët e shumtë shqiptarë, të të gjithave viseve jashtë Shqipërisë së cunguar padrejtësisht, ku veçohen i urti profesor Anton Çetta si dhe profesor Zekeria Cana, të cilët, pas ftesës që ua kishin bërë, nga fillimi u bënë krah i djathtë i nismëtarëve, si dhe i mijëra qytetarëve të tjerë të të gjitha moshave dhe gjinive, të të gjitha profesioneve, të të gjitha qyteteve dhe rajoneve. Tërësisht në frymën demaçiane, në frymën kombëtare të Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), nismëtarët e çuan Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve kudo ku kishte shqiptarë, përfshirë edhe Tetovën e Gostivarin, Preshevën e Bujanovcin, duke mos anashkaluar edhe shqiptarët me banim në trojet e tyre në Mal të Zi. Një bashkim të tillë kombëtar shqiptarët nuk e kishin përjetuar asnjëherë më parë. Ata tashmë jo vetëm që po rinjihnin veten e tyre, vlerat e veta humane universale, por po njiheshin dhe po bashkoheshin fuqishëm me njëri-tjetrin si në baza familjare, ashtu edhe kombëtare. Po mbushnin përplot vendtubimet ku faleshin gjaqet, plagët dhe ngatërresat, duke çuar edhe në mbi gjysmë milioni

numrin e pjesëmarrësve, siç ishte rasti më 1 maj 1990, në tubimin e mbajtur te Verrat e Llukës të komunës së Deçanit, ku si bashkëdrejtues, krahas Have Shalës, ishte edhe ish i burgosuri tjetër politik, Jashar Salihu. Dhe është plotësisht e natyrshme, që shumica e tubimeve të tilla të mëdha hapeshin me thirrjen-kushtrim të Adem Demaçit: “*Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit*”!<sup>20</sup>

Shqiptarët e pajtuar dhe të bashkuar, pa barrën e rëndë të gjakmarrjes mbi supet e tyre të lodhura nga pesha e rënduar e robërisë, duke çliruar fizikisht veten e tyre, tashmë kishin arritur një nga parakushtet elementare, të domosdoshme, për realizimin e qëllimit final të Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH): çlirimin e vendit të pushtuar. Këtë e jetësoi Lëvizja e Demaçit, e transformuar nëpër faza historike dhe duke përfshirë në vete edhe grupe të tjera politike atdhetare, herë me emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe e Viseve të Tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ), e themeluar në vitin 1978<sup>21</sup>, herë si Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), për të arritur së fundmi, nga Mbledhja IV e Përgjithshme, e mbajtur në Prishtinë në gusht të vitit 1993<sup>22</sup>, te Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK), pjesëtarë ose simpatizantë të së cilës ishin shumica e nismëtarëve të Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve. Ajo, duke pasur në themele gjakun e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, e themeloi më 17 nëntor 1994 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)<sup>23</sup>, e organizoi dhe mobilizoi popullin, e drejtoi luftën çlirimtare, çliroi dhe pavarësoi Kosovën, duke pasur përkrah pashkëputshëm shtetin amë, Shqipërinë, si dhe Aleancën Veri-Atlantike të NATO-s. U tha që në fillim: emri i Adem Demaçit është i lidhur ngushtë, pazgjidhshëm me çlirimin, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Siç është i lidhur ngushtë po ashtu

<sup>20</sup> Kadri Rexha, *Fati i luleve*, “Buzuku”, Prishtinë, 1993, 86.

<sup>21</sup> Selatin Novosella, *Metush Krasniqi - personalitet unifikues i Lëvizjes Kombëtare*, Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, Prishtinë, 2011, 18.

<sup>22</sup> *Programi dhe Statuti i LPK-së*, Prishtinë, 1993, 4.

<sup>23</sup> Xhavit Haliti, Intervistë në TV “Klan Kosova”, 22.12.2015.

edhe me Lëvizjen e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë, si një nga kushtet më të domosdoshme për të arritur bashkimin dhe për të mbledhur të gjitha forcat, resurset humane dhe materiale, për të filluar dhe kurorëzuar me sukses luftën e armatosur çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Pozicioni i Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik të UÇK-së, shënon kulmin e karrierës politike të Adem Demaçit.<sup>24</sup> Në këtë linjë, shumica e nismëtarëve të pajtimit të gjaqeve ishin gjithashtu pjesëtarë të UÇK-së, kurse Adem Grabovci<sup>25</sup> ishte edhe anëtar i Shtabit të saj të Përgjithshëm.

---

<sup>24</sup> Bardhyl Mahmuti, *Krimi i gjenocidit në Reçak dhe Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë*, Intervistë në gazetën “Epoka e re”, 26.12.2023, 5.

<sup>25</sup> Jakup Krasniqi, *Kthesa e Madhe - Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, “Buzuku”, Prishtinë, 2007, 137.